



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Shkurt, 2021
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes dhe ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit shkurt të vitit 2021, ka arritur me sukses dhe në kohë optimale t'i realizojë punët dhe detyrat të parapara me planin e veprimit me punë dhe detyra tjera të paraqitura.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planin programin e Komunës për drejtorinë tuaj.

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja dhe mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Sigurohet buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit të (DKA-së shkollë), mësimeve të dalluar sipas performances;

- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave dhe sfidave, vështirësive dhe pengesave;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizohen takime dhe punëtori për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësohet gjendja e përgjithshme e infrastrukturës;
- Sigurohen dhe menaxhohen fondet për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re;
- Kryesisht sigurohet pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Krijimi i ekipit për identifikimin e nevojave të shkollave për teknologji arsimore;
- Ekipi në fjalë hulumton trendet e fundit të përdorimit të teknologjisë arsimore në vend dhe jashtë;
- Bëhet identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë, kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësohet personeli për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap, pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti, e të tjerë në IP me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;-
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;

- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT-in dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA-ja përkrahë NNV-në dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA-ja, harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimi nëpër shkollë;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance;

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër.

Theksoni të arriturat e drejtorisë.

- Mbështetja dhe mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar në komunën tonë, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim

dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale, në këtë kohë pandemie që po kalon vendi.

Sipas dinamikës së planifikuar përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, gjatë muajit shkurt kanë realizuar planin operues si: vizita informuese, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar.

Pra, në kuadër të mbikëqyrjes dhe mbështetjes profesionale në të gjitha dimensionet që janë paraqitur nevojat.

Kështu që, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit shkurt të vitit 2021, është realizuar plani i punës.

Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar 3 vizita informuese, si në:

- SHFMU “Shkolla e Gjelbër”;
- SHFMU “Nazim Gafurri”;
- SHFMU “Emin Duraku”.

- 36 vizita kontrolluese lidhur me procesin e planifikimit dhe realizimit të kontratave me kuotim se a janë realizuar dhe implementuar kontratat sipas rregullave të prokurimit dhe procedurave ligjore që e rregullojnë këtë segment, në shkollat të cilat janë mbështetur në këtë formë.
- Andaj nga fundi i muajit janar 2021, ekipet e DKA-së kanë filluar kontroll sistematik në institucionet përfituese.

Drejtoria e Arsimit, gjatë vitit 2020 në funksion që institucionet arsimore t’ju lehtësohet dhe mundësohet plotësimi dhe realizimi i kërkesave të tyre, i ka mbështetur në të gjitha dimensionet që punët dhe detyrat e tyre të planifikuara të realizohen me sukses dhe efektivitet të lartë, në të mirë të përmirësimit të kushteve në shkolla, veçmas gjatë kësaj kohe që po kalon vendi dhe e tërë bota si rezultat i përhapjes së pandemisë COVID-19.

Andaj, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, nga data 29.01.2021, filluan në mënyrë sistematike realizimin e vizitave në të gjitha institucionet arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar të Komunës së Prishtinës.

Vizitat kishin karakter kontrollues: kontrollimin e gjithë dokumentacionit të nevojshëm mbi planifikimin dhe realizimin e kontratave kuotimit dhe kontrollimin e materialit të blerë me kontratë.

Për të verifikuar nga afër gjendjen në secilën shkollë, zyrtarët e DKA-së, në prezencën e stafit drejtues të shkollës bënë kontrollimin e dokumentacionit (kontratën me kuotim), dhe materialit në shkollë, si në:

- IP “Gëzimi Ynë”;
- IP “Dielli”;
- IP “Yllkat”;
- IP “Lulevera”;
- IP “Ardhmënia”;

- SHFMU “Ismail Qemali”;
- SHFMU “7 Marsi”;
- SHFMU “Dardania”;
- SHFMU “Xhavit Ahmeti”; SHFMU “Shkolla e Gjelbër”;
- SHFMU “Nazim Gafurri”;
- SHFMU “Emin Duraku”;
- SHFMU “Qamil Batalli”;
- SHFMU “Meto Bajraktari”;
- SHFMU “Nexhmi Mustafa”;
- SHFMU “Ali Kelmendi”;
- SHFMU “Dituria”;
- SHFMU “Xhemail Mustafa”;
- SHFMU “Mehmet Gjevori”;
- SHFMU “Isa Boletini”;
- SHFMU “Avni Rrustemi”;
- SHFMU “Ditët e Minatorit”;
- SHFMU “Shkëndija”;
- SHFMU “Dëshmorët 1921”;
- SHFMU “Rilindja”;
- SHFMU “Tefik Çanga”;
- SHFMU “Ganimete Tërbeshi”;
- SHFMU “Elena Gjika”;
- SHFMU “Andon Z. Çajupi”;
- SHFMU “Hilmi Rakovica”
- SHFMU “Zenel Hajdini”;
- SHML “Gjin Gazulli”
- SHML “Ahmet Gashi”;
- SHML “Sami Frashëri”;
- SHML “Abdyl Frashëri”;
- SHML “28 Nëntori”;
- SHML “Xhevdet Doda”.

- **Vizita të përgjithshme:**

SHFMU “Xhemail Mustafa” dhe gjimnazin “Matematik”

- **Vizita speciale:**

- SHML “Hoxhë K. Prishtina”;
- SHML “Xhevdet Doda” ;
- IP “Ardhmënia”;
- Në muajin shkurt është realizuar një analizë dhe vlerësim i përgjithshëm mbi raportet e koordinatorëve të cilësisë për punët dhe detyrat e realizuara, ku në

disa raste është vërejtur se nuk kanë treguar kompetencë dhe profesionalizëm për ushtrimin e detyrës së koordinatorit të cilësisë, duke mos arritur t'i realizojnë punët dhe detyrat siç është e përcaktuara me Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2016, për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar;

Pra, është indikativ fakti se politikat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për funksionalizimin e koordinatorëve të cilësisë për secilin institucion të nivelit të arsimit parauniversitar, konsiderohet i dobishëm dhe progresiv për zhvillimin e proceseve arsimore, por fatkeqësisht ky proces nuk është studiuar në detaje nga MASH-ti, duke përcaktuar që këtë pozitë të ushtrojnë mësimdhënësit të cilët janë në proces mësimor;

Por, nga vlerësimi i të dhënave të prezantuar nga koordinatorët, konstatohet se kjo mënyrë e konceptuar për funksionalizimin e koordinatorëve të cilësisë sipas UA, nuk ka reflektuar pozitivisht duke mos përmbushur kërkesat sipas standardeve të përcaktuara për realizimin e kësaj detyre me profesionalizëm.

Andaj, nga analiza e realizuar mbi punët dhe detyrat e koordinatorit të cilësisë, konsiderohet sfiduese çështja e përcaktimit të koordinatorit të cilësisë, sepse mësimdhënësit nuk kanë treguar kompetencë dhe profesionalizëm të duhur për realizimin e kësaj detyre.

- **Zhvillimi profesional i edukatorëve:**

Në funksion të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale të edukatoreve të nivelit parafillor të komunës sonë, më datë 06 shkurt 2021, filloi faza e parë e trajnimit të tyre, "Përgatitja e Edukatorëve Parafillor për Përkrahjen dhe Zhvillimin e Potencialit të Fëmijëve përmes Lojës dhe Kreativitetit";



Andaj, ky trajnim do të zhvillohet në katër faza për të gjitha edukatorët e

institucioneve edukativo-arsimore, të nivelit të arsimit parafillor;

Trajnimi do të organizohet dhe zhvillohet në bashkëpunim dhe bashkëveprim me Caritasin Zvicëran dhe IPK;

Është indikativ fakti se investimi në fëmijërinë e hershme, është bazamenti për një të ardhme më të ndritur për shoqërinë tonë.

- **Ngritja e kapaciteteve profesionale të drejtuesve të shkollave dhe koordinatorëve:**

Më datë 19 shkurt 2021, Asociacioni i Drejtorëve të Shkollave të Komunës së Prishtinës (ADSHKP), filloi organizimin dhe mbajtjen e trajnimit për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të drejtuesve të shkollës dhe koordinatorëve të cilësisë, për **Vlerësim të brendshëm të shkollës**.

Trajnimi është planifikuar të realizohet në tri grupe, të ndarë nga 13 shkolla: grupi i parë do të mbahet në shkollën fillore “Faik Konica”, grupi i dytë në shkollën fillore “Qamil Batalli”, dhe grupi i tretë në gjimnazin “Ahmet Gashi”, ku pjesëmarrës në këtë trajnim do të jenë drejtori i shkollës dhe koordinatori i cilësisë;

Andaj, DKA-ja në koordinim dhe bashkëveprim me asociacionin e drejtorëve të shkollave, në funksion të përmirësimit dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale të drejtuesve të shkollave për udhëheqje dhe menaxhim të institucioneve edukativo-arsimore, do t’i mbështet në mënyrë permanente, sepse kjo mbështetje profesionale do të reflekton drejtpërsëdrejti në ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë në shkolla dhe dimensione tjera.



- **Olimpiada e Matematikës:**

Më datë 20 shkurt 2021, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në bashkëpunim me Shoqatën e Matematikanëve të Kosovës organizuan garën “Olimpiadën Matematike”, garë e cila ka për qëllim nxirrje në pah të shkathtësive dhe kompetencave të nxënësve të arritura në shkencën e matematikës, identifikimin e talenteve të ri dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.



Pjesëmarrës në këtë garë ishin 83 nxënës të klasave IX-XII nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore publiko dhe private, ku në këtë garë secila shkollë u përfaqësua me nxënës që treguan rezultate të larta në nivel shkolle.

Ndërsa, nxënësit të cilët do të shënojnë rezultate të mira në nivel komune, do të përfaqësojnë Komunën e Prishtinës në nivel vendi dhe pastaj në nivel ndërkombëtar, ku këtë vit do të mbahet në St. Petersburg, në Rusi, prej datës 14. 07.



2021 deri më datën 24. 07. 2021, ku Kosova merr pjesë për herë të njëmbëdhjetë në cilësinë e anëtarit me të drejta të plota.

Nxënësit e komunës së Prishtinës edhe në garat në nivel ndërkombëtar, vazhdimisht kanë arritur suksese dhe rezultate të larta, andaj për vitin 2019, urojmë që sukseset dhe rezultatet e tyre të jenë edhe më të larta.

- **Gara “Fizikanët e rinj”:**

Më 21 shkurt 2021, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në bashkëpunim me Shoqatën e Fizikanëve të Kosovës, organizuan garën e “Fizikanëve të Rinj” në nivel komune. Gara u zhvillua me nxënësit e klasave të IX, X, XI dhe të XII, nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar. Në garën e fizikanëve të rinj, secila shkollë u përfaqësua me nxënës që kanë treguar rezultate të larta në garën në nivel shkolle.



Ndërsa, nxënësit që do të shënojnë rezultate të mira në nivel komune do të përfaqësojnë Komunën e Prishtinës në nivel vendi më 28 shkurt 2021, garë kjo që do të mbahet në Fakultetin e Shkencave Matematikore-Natyrore (Departamentin e Fizikës), të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.



Nga nxënësit fitues të këtyre garave do të përzgjidhen dy ekipe nga 5 nxënës për të përfaqësuar shtetin e Kosovës në Olimpiadën Ndërkombëtare të Fizikës (International Physics Olympiad - IPhO) dhe në Olimpiadën Europiane të Fizikës (European Physics Olympiad - EUPhO).

Qëllimi dhe organizimi i garës me karakter të tillë, është në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, nxjerrjes në pah të shkathtësive dhe kompetencave të arritura nga nxënësit në shkencën e fizikës, identifikimin e talenteve të reja dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.

- Për të krijuar kushte dhe mundësi më të mira në institucionet edukativo-arsimore dhe për të ndihmuar në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për nxënësit tanë, gjatë muajit shkurt Qendra e Karrierës ka dhuruar një donacion prej 12 kompjuter për gjimnazin “Sami Frashëri” dhe gjimnazin “Xhevdet Doda”.



- Pra, furnizimi me këto pajisje teknologjike në këtë kohë pandemie do t’ju ndihmon shkollave që të mbajnë edhe mësim në distancë në rast nevojë;

- Drejtoria e Arsimit, në funksion të krijimit të kushteve dhe mundësive më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore, gjatë muajit shkurt ka finalizuar rregullimin e sallës së edukatës fizike në shkollën fillore të mesme të ulët “Zenel Hajdini”, duke krijuar kushte dhe mundësi sipas kushteve dhe standardeve të larta.



Po ashtu, gjatë muajit shkurt është intervenuar në përmirësimin e infrastrukturës në dy institucionet parashkollore IP “Fatosat” dhe IP “Yllkat”, konkretisht rregullimin e oborreve dhe rrethojave.



- Aktivitet profesional (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë muajit shkurt të vitit 2021, kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara, duke përgatitë raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë;
- Po ashtu, aktivitet profesional në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe monitoruar nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa, Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i ka mbështetur me këshilla profesionale aktivitet profesional dhe i mban të informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit dhe u ka përgatitë formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimi jo formal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të parapara;
- Realizimin e praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale gjatë muajit shkurt nuk është duke u realizuar si pasojë e COVID-19, por shkollat janë duke u munduar që të mbajnë në shkollë;
- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin Administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim.
- Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta ekipi në nivel komune ka operuar sipas planifikimeve të parapara për vlerësimin dhe adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet përkatëse.
- Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues 2 fëmijë dhe të dytë janë referuar në Qendër Burimore "Përparimi";
- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhune apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, drejtoria merr masa të menjëhershme komform legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe rregullores komunale për arsim;
- Takime të rregullta me zyrtar për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkollë;
- Takime me prindër të shkollave të ndryshme;
- Vizita në shkollë sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit shkurt;

- Procedimi i lëndëve në departamentin e prokurimit për shpallje të kërkesave të institucioneve edukativo-arsimore, sipas planit të prokurimit 2021;
- Përcjellja e të dhënave të mësimdhënësve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, lidhur me pagesën shtesë nga 100 euro;
- Kompletimi i lëndëve për pagesë të kontratave të furnizimeve dhe shërbimeve të bëra në institucionet arsimore;
- Përpunimi i të dhënave statistikore, lidhur me orët e realizuara të gjysmë vjetorit të parë për vitin shkollor 2020-2021;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore;
- Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga tre përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike, mallra dhe shërbime tjera;
- Furnizimi me inventar i disa institucioneve edukativo-arsimore;
- Janë furnizuar institucionet edukativo-arsimore me lëndë djegëse për ngrohje;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Stimulimi i menaxhmentit të (DKA-së shkolle), dhe mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Krijimi i ekipit për identifikimin e nevojave të shkollave për teknologji arsimore;
- Ekipi në fjalë hulumton trendët e fundit të përdorimit të teknologjisë arsimore në vend dhe jashtë.

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për muajin shkurt-2021;

Buxheti i shpenzuar dhe alokuar shkurt-2021				
Kategoria Eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim - Obligim	Mbetje -S=
Paga	1,562,603.95	1,562,603.95	-	-
Komunali				
10-MSH				
21-MSH				
Subvencione				
Donacione				
FB-21-Kapitale				
FB-22-Kapitale				-
Totali:	1,562,603.95	1,562,603.95	-	-

3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit shkurt të vitit 2021, ka realizuar mbi 37 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën shkurt të vitit 2021, janë realizuar takime me:

- Takim me sekretarin e përgjithshëm të MASH-it;
- Takim me përfaqësuesit e MASH-it;
- Takim me përfaqësuesin e zyrës së financave të MASH-it;
- Takim me përfaqësuesit e GIZ-it;
- Takim me Nënkryetarin e Komunës së Prishtinës;
- Takim me Drejtoreshën e Financave të Komunës së Prishtinës;
- Takim me KEPTSH;
- Takim me përfaqësuesit e departamentit të psikologjisë, të Fakultetit Filozofik;

- Takim me përfaqësuesit e Fakultetit të Edukimit;
- Takim me përfaqësuesit e Fakultetit Filologjik;
- Takim me përfaqësuesit e kompanisë të cilët janë duke e hartuar Planin Zhvillimor të Komunës;
- Takim me drejtorin e organizatës joqeveritare ETEA;
- Takim me drejtorin e Mirëqenies Sociale;
- Takim me përfaqësuesit e KUR-Prishtina;
- Takimet me përfaqësuesit e KEDS-it;
- Takim me përfaqësuesit e PTT-së;

4.1.1. Diskutime Publike dhe Takimet me qytetarë

5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare;

- Gjatë muajit shkurt të vitit 2021, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

5.1.1. Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit shkurt të vitit 2021, janë pranuar gjithsej 50 lëndë, prej tyre të miratuara janë 3, të refuzuara 3 lëndë, të pezulluara 15 dhe në proces janë edhe 29.

6. Takime të tjera

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës.

7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi, përgjegjësi, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës të stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjor në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Implementimi i kurrikulës së re;

- Infektimi i mësimeve me virusin COVID-19, dhe zëvendësimi i tyre;
- Mësuesit që vuajnë nga sëmundjet e rënda kronike dhe pamundësia për t'i zëvendësua me staf të ri;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimit në distancë (online).

8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandimet rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë Komunale të Arsimit, në bazë të përgjegjësi, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimor;
- Sigurohet staf arsimor, për zëvendësimin e mësimeve që vuajnë nga sëmundjet e rënda kronike dhe të cilët janë të infektuar me virusin COVID-19;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të Komunës së Prishtinës.

9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimor;
- Vizita speciale në IEAA;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja dhe mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurohet buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit të (DKA-së shkolle), mësimeve të dalluar sipas performancës;

- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Hartohen politika dhe rregullore për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave, sfidave, vështirësive dhe pengesave;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizohen takime dhe punëtori për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Vlerësohet gjendja e përgjithshme e infrastrukturës;
- Sigurohen dhe menaxhohen fondet për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re;
- Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikohen nevojat e shkollës për mjete të TIK-ut;
- Ekipi në fjalë hulumton trendet e fundit të përdorimit të teknologjisë arsimore në vend dhe jashtë;
- Bëhet identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë, kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësohet personeli për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtar të arsimit, zyrtar të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës, etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH-

së (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim por edhe si këshillues e përkrahës në të të përfshihen edhe profesionist – ekspert;

- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH-së;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi jo formal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT-in dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtë kurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA-ja përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së ekipit komunal për vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonim;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore renovimi dhe zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA-ja harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës dhe mësimi nëpër shkollë;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.